

A ju është refuzuar azili ju dhe familjes suaj? A keni marrë një letër nga Ministria e Brendshme (Home Office) me titull ‘Statusi juaj në MB dhe Shtojca 3 e Ligjit të Kombësisë, Imigracionit dhe Azilit 2002’?

Nëse e keni marrë këtë letër, NASS (Shërbimi Kombëtar i Ndhimave për Azilantët) mund t’ju thotë që ndihma që merrni do t’ju ndërpritet, vetëm nëse largoheni nga Mbretëria e Bashkuar. Sidoqoftë, keni disa mundësi të ndryshme, por është e rëndësishme që të kërkonti këshilla sa më shpejt që të jetë e mundur nga qendra juaj më e afërt e këshillave për refugjatë.

Kujt ia dërgon këtë letër Ministria e Brendshme?

Ministria e Brendshme nuk ia dërgon këtë letër çdo familje - shumica e familjeve do të vazhdojnë të marrin ndihma nga NASS, derisa fëmija i tyre më i vogël të mbushë moshën 18 vjeç. Sidoqoftë, Ministria e Brendshme mund t’ia dërgojë një letër të tillë:

- Familjeve që kanë fëmijë në MB nën moshën 18 vjeç dhe
- Atyre që u është refuzuar azili dhe nuk kanë më të drejtë të mëtejshme apeli.

Çfarë do të thotë kjo letër?

Do të thotë që Ministria e Brendshme dëshiron që familja juaj të largohet vullnetarisht nga MB dhe NASS mund t’jua ndërpresë ndihmat, nëse nuk veproni në këtë mënyrë. Sidoqoftë, ndihma nuk duhet t’ju ndërpritet, nëse:

- NASS pranon që po përpiqeni të largoheni nga MB (për shembull, nëse po aplikoni për dokumenta udhëtimi, ose tek një program kthimi në mënyrë vullnetare) ose
- NASS mendon që do të shkelen të drejtat tuaja të njeriut, nëse NASS ndërpret ndihmat.

Nga do ta dijë Ministria e Brendshme që po përpiqeni të largoheni nga MB, ose është shkelje e të drejtave të njeriut, nëse NASS jua ndërpret ndihmat?

- Ata do të shikojnë dosjen tuaj, nëse keni aplikuar për dokumentat e udhëtimit, ose nëse po përpiqeni të ktheheni në mënyrë vullnetare në vendin tuaj të origjinës. Nëse nuk e keni bërë këtë, ata do t’ju shkruajnë një letër dhe do t’ju kërkojnë të merrni pjesë në një intervistë. Ata mund t’ju kërkojnë gjithashtu të raportoni çdo javë, ose çdo muaj në një nga Zyrat lokale të Imigracionit.
- Në intervistë do t’ju pyesin se ç’përpjekje keni bërë për largimin nga MB. Nëse nuk keni bërë asgjë, ata do t’ju pyesin për arsyen (për shembull, mund të jeni shumë i sëmurë për të udhëtuar).
- Në intervistë, ata do t’ju pyesin gjithashtu për familjen, shëndetin tuaj, edhe nëse keni ndonjë përkrahje tjetër (për shembull, nëse mund të qëndroni tek ndonjë mik). Ata do t’jua bëjnë këto pyetje për të mësuar nëse do të shkelen të drejtat tuaja të njeriut, nëse jua ndërpresin ndihmat (me fjalë të tjera, nëse sëmureni, gjendja juaj bëhet tepër e vështirë, ose nuk keni mundësi të gjeni banesë, ushqim dhe shërbimet e larjes).

Çfarë do të ndodhë më tej?

- Nëse NASS mendon se do të shkelen të drejtat tuaja të njeriut, ata nuk mund t’ua ndërpresin ndihmat.
- Nëse NASS vendos t’ua ndërpresë ndihmat, ata do t’ju dërgojnë një letër për t’jua shpjeguar këtë - ndihma do të ndërpritet pas 14 ditëve (të paktën 2 muaj, pasi të keni marrë letrën e parë nga Ministria e Brendshme). Mund të apeloni kundra këtij vendimi, ju lutemi të na kontaktoni në rast ndihme. Sidoqoftë, nëse ndërpritet ndihma e NASS, Autoriteti juaj Lokal mund të japë ndihma për fëmijët nën moshën 18 vjeç, si dhe për ju dhe të rriturit e tjerë në familjen tuaj.

Nëse keni ndonjë pyetje, ose dëshironi të bisedoni në mënyrë të besueshme për mundësitë tuaja, ju lutemi të kontaktoni agjencinë tuaj më të afërt të këshillimeve, ose Shërbimet e Shpejta (One Stop Shop):